



**RAPORT
MONITORIMI I SEKTORIT
TË MJEDISIT NË KOMUNËN
E PRIZRENIT**

**20
22**



RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E PRIZRENIT – 2022

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren,
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7

www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org

029 222 771/038 224 967

Raporti “MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E PRIZRENIT – 2022” është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cilimbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj “Human Rightivism” që implementohet nga Community Development Fund – CDF.

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.



Maj, 2023

PËRMBAJTJA:

Hyrje

Gjetjet e raportit

01

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Statistikat Kryesore - 2022

02

Korniza ligjore

03

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

04

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Raportet mjedisore në nivelin lokal

05

Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të të dhënave.

06

Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

07

Licencimi dhe lejet mjedisore

Përfundime

Rekomandimet

Për EC

Hyrje

Ky raport është një përpjekje e re e strukturuar e shoqërisë civile për të adresuar e trajtuar përgjegjësitë e organeve kompetente të Qeverisë Lokale, përkatësisht përgjegjësitë e Komunave karshi 7 aspekteve mjedisore që rregullohen me kornizën ligjore të vendit.

Organet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit janë të rregulluara në forma të ndryshme në Komunitat e Kosovës. Disa nga komunitat kanë drejtori të dedikuara për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa disa kanë sektore në kuadër të drejtorive për planifikim apo zyrtarë përgjegjës për çështje mjedisore.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit

Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës

Ligji nr.03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Ligji nr.2003_3 për pyjet e Kosovës

Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës

Ligji nr.04/L-060 për mbeturina

Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike

Ligji nr.03/L-119 për produktet biocide dhe shtojcat

Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë

Ligji nr.04/L-197 për kimikate

Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor

Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Mbi këtë bazë përmbajtja e këtij raporti tenton që të mbulojë aspektet kryesore që legjislacioni në fuqi adreson, si:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
- Korniza ligjore
- Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit
- Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
- Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave
- Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Gjetjet e këtij raporti në kapituj të caktuar kanë identifikuar mangësitë aktuale në sektorin e mjedisit, që kërkojnë vëmendje më të shtuar nga autoritetet komunale, me qëllim të përmirësimit të procesit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor. Gjithashtu ato janë validuar nga zyrtarët përkatës komunalë, si pasqyrim i gjendjes reale në sektorin e mjedisit. Njëherësh kanë theksuar se burimet njerëzore dhe financiare nuk janë në nivel të mjaftueshëm, gjë që mbase reflektohet edhe në gjendjen aktuale mjedisore.

Në fund janë adresuar edhe disa rekomandime me qëllim të përmirësimeve dhe plotësimeve në proceset e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, drejt arritjes së rezultateve më të qëndrueshme në sektorin e mjedisit dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

Gjetjet e raportit

1. Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Prizrenit organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Sektori i Mjedisit dhe i Menaxhimit të Mbeturinave që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Stafi i DSHP-së, njëjtë sikurse në vitin 2020/2021, përbëhet prej gjithsejtë 14 punonjësve, prej të cilëve 5 zyrtarë janë të angazhuar në Sektorin e Mjedisit dhe të Menaxhimit të Mbeturinave.

Ky sektor përbëhet prej udhëheqësit të sektorit, bashkëpunëtorit profesional për mjedis, përgjegjësës për menaxhimin e mbeturinave, inspektorit për mjedis dhe shërbyesit në sportel (arkëtarit).

ORGANI KOMUNAL	A ËSHTË THEMELUAR?	EMRI ZYRTAR	FUQIA AKTUALE PUNËTORE
Drejtoria	Po	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim	14
Spektori	Po	Spektori i Menaxhimit të Mbeturinave, Ambientit dhe Eficiences dhe Energjisë	5
Zyrtarët		Udhëheqësi i Sektorit të Mjedisit dhe Mbeturinave; Bashkëpunëtor i Profesional për Mjedis; Përgjegjësja për Menaxhimin e Mbeturinave; Inspektori për Mjedis; Shërbyesi në sportel (arkëtar)	5

Sipas zyrtarëve të anketuar numri i angazhuar i shërbyesve civil nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, pasi që bazuar në programin e Sektorit të Mjedisit dhe Menaxhimit të Mbeturinave të hartuar nga JICA, numri i zyrtarëve të angazhuar në këtë sektor duhet të jetë 16. Sipas tyre shërbyesit civil në SMMM kanë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, ku nga shkalla 1 (aspak) deri në 5 (shkëlqyeshëm) kanë dhënë vlerësimin 4.

SMMM ka bërë të ditur se gjatë vitit 2022 për punonjësit e këtij sektori nuk janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore, as nga niveli qendror, e as nga komuna apo ndonjë organizatë tjetër. Gjithashtu në vitin 2022 nuk është organizuar asnjë trajnim rreth çështjeve mjedisore për stafin e SMMM, as nga niveli qendror, e as nga komuna apo ndonjë organizatë tjetër, por sipas tyre në këtë pjesë vlen të theksohen vetëm trajnimet e mëhershme të organizuara nga Agjencioni Japonez “JICA” mbi menaxhimin, trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave, trajnime gjatë të cilave janë organizuar edhe vizita në Japoni.

Stafi i SMMM gjatë vitit 2021 nuk ka shfrytëzuar ndonjë udhëzues profesional për planifikimin dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore, por gjatë kryerjes së detyrave kryesisht është fokusuar në legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike.

Statistikat Kryesore - 2022:

- Numri i zyrtarëve të angazhuar në SMMM – 5
- Numri i trajnimeve rreth kornizës ligjore – 0
- Numri i trajnimeve sipas fushës mjedisore – 0
- Numri i Udhëzuesve Profesional për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor – 0

2. Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Prizrenit, përkatësisht SMMM ka raportuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

1. Plani Lokal i Veprimit Mjedisor 2014-2018
2. Rregullorja Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave Nr. 01/011-31308, 19 shtator 2015
3. Plani Pesëvjeçar i Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta 2013-2018, shtator 2013
4. Plani Master për Menaxhimin e Mbeturinave 2014-2023, Nr. 01/011-161014, 03 shtator 2015
5. Ligji Nr. 02/L-30 për Menaxhimin e Mbeturinave
6. Ligji Nr. 03/L-024 - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
7. Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit
8. Ligji NR. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës
9. Ligji nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit
10. Ligji Nr.04/ L-147 për ujërat e Kosovës
11. Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma

Zyrtarët e SMMM të Komunës së Prizrenit kanë shprehur bindjen se korniza ligjore mjedisore është pjesërisht e konsoliduar. Por nuk kanë listuar mangësitë kryesore ligjore të cilat i hasin gjatë punës së përditshme. Sipas tyre, Plani Lokal i Veprimit Mjedisor është hartuar për periudhën 2014-2018 dhe se edhe këtë vit nuk ka pasur ndonjë iniciativë për hartimin e një plani të ri për periudhën në vazhdim.

Ndërsa njohuritë e stafit të këtij sektori rreth kornizës respektive ligjore i kanë notuar me 4, nga 1/aspak deri 5/shkëlqyeshëm.

3. Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Sikurse një vit më parë, rrjedha e ciklit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor nuk shquhet për qasje të strukturuar dhe të organizuar. Hartimi i politikave mjedisore kërkon dinamizim me qëllim që ato ti përgjigjen nevojave të kohës. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis ka skaduar në vitin 2018 dhe nuk është hartuar plani i ri.

Programet mjedisore sipas SMMM edhe përgjatë vitit 2022 kanë përfshirë fushën Vetëdijesimit ku janë shënuar ditë të ndryshme mjedisore dhe janë realizuar anketa me qytetarë, po ashtu është punuar edhe drejt Eliminimit të Pikave të Zeza, Minimizim e Mbeturinave ku janë shpërndarë komposter dhe është organizuar kampanjë për rëndësinë e përdorimit të komposterëve, Edukimin në Shkolla, por përsëri edhe këtë vit nuk janë prezantuar raportet e zbatimit si dhe rezultatet e arritura.

SMMM ka raportuar se projektet e kontraktuara janë menaxhimi i mbeturinave, mirëmbajtja e rrugëve, shesheve dhe hapësirave të gjelbra dhe shtratit të gjatë sezonit dimëror dhe veror, dhe shtratit të Lumbardhit, hartimi i disa projekteve infrastrukturore, pastaj furnizimi me kontejnerë, etj.

Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit në vitin 2022 sipas SMMM përfshijnë mirëmbajtjen e shtratit të Lumbardhit, sikurse edhe furnizimin me disa pajisje për matjen e zhurmës, për matjen e radioaktivitetit, për matjen e ndotjes së ujit, për matjen e cilësisë së ajrit.

Sipas zyrtarëve, hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit janë në përputhje me strategjitë mjedisore në fuqi. Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor në vitin 2022 kanë vazhduar që të jenë në nivel modest.

Lloji i planit	Emri i dokumentit	Statusi	Koha e hartimit	Kohëzgjatja e mandatit	Hartuesi	Disponueshmëria e raporteve të zbatimit
Planet Lokal i Veprimit në Mjedis	Planet Lokal i Veprimit në Mjedis 2014 – 2018	Skaduar	2014	2014-2018	Nuk është ofruar informata	Nuk është ofruar informata
Programet Mjedisore	Vetëdijesimi Eliminimi i pikave të zeza Minimizimi i mbeturinave Edukimi në shkolla Promovimi i programit të adoptimit	/	Vjetore	/	/	Nuk është ofruar informata
Vlerësimi Strategjik Mjedisor	/	/	/	/	/	Konsiderohet jashtë fushës së SMMM
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Është ofruar lista e lejeve mjedisore	/	/	/	/	/
Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave	Plani Master për Menaxhimin e Mbeturinave 2014-2023	/	2014	2014-2023	/	/
Plani Zhvillimor Komunal	Plani Zhvillimor Komunal 2013-2025	Në fuqi	2013		UTS, UDS	Konsiderohet jashtë fushës së SMMM
Harta Zonale e Komunës	Harta Zonale e Komunës	Draft, është mbyllur shqyrtimi publik	2020		Prima Eng.	Konsiderohet jashtë fushës së SMMM
Plani i rregullimit të tokës	Nuk janë ofruar Informata	/	/	/	/	Konsiderohet jashtë fushës së SMMM
Programi për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave	Nuk janë ofruar Informata	/	/	/	/	Konsiderohet jashtë fushës së SMMM

Projektet kapitale të nivelit lokal për rregullimin, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit

Emri i projektit	Statusi	Periudha e realizimit	Vlera e kontratës	Autoriteti kontraktues	Lokacioni	Fusha tematike	Partneri zbatues	Plani
Menaxhimi i mbeturinave, grumbullimi, transporti dhe deponimi	Kontratë kornizë	Deri më datë 01.02.2023	2.909.831,52 € / 36 muaj, 121,242.98 € / muaj	Komuna e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	Ajër, Dhe, Ujë, Biodiversitet	KRM "Ecoregjioni"	/
Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, shesheve, hapësirave të gjelbëruara, shtratit të lumbardhit dhe largimi i borës, Zona e parë dhe e dytë (I+II)	Kontratë në shtëpi	30.09.2022 – 30.09.2025	4323.324.00€	Komuna e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	Ajër, Dhe, Ujë, Biodiversitet	KRM "Ecoregjioni"	/
Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, shesheve, hapësirave të gjelbëruara, shtratit të lumbardhit dhe largimi i borës, Zona e tretë (III)	Kontratë / në shtëpi	/	1951494.20€ 07.06.2022 – 06.07.2025	Komuna e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	Ajër, Dhe, Ujë, Biodiversitet	KRM "Ecoregjioni"	/
Shërbimet e varrimit dhe mirëmbajtja e varrezave	Kontratë / në shtëpi me nr. të protokollit 01. nr. 100/19	/	0.09€/1 m2	Komuna e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	/	KRM "Ecoregjioni"	/

Projekte ambientale - trajtimi dhe rrethimi i hapësirave me interes publik - projekt tre vjeçar (Piranë dhe Ortakoll)	Kontratë kornizë	20.10.2021	9174.00€ të paguara	Komuna e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	/	/	/
Mirëmbajtja dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në Komunën e Prizrenit	Kontratë kornizë	/	510,94€	Komuna e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	/	Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.T. Bamirs ; N.P.SH. BREDHI	/
Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të Lumbardhit nga ura afer kampusit në vazhdim të rrjedhës	Kontratë	/	29 777,00€	Komuna e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	/	Grup i Operatorëve Ekonomik G-PROJECT; N.SH. Smart Architecture	/
Furnizimi dhe me konteiner per plehra	Kontratë	/	39174.25€	Komuna e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	/	AGRIUM SHPK – Llashkobarë - Ferizaj	/
Hartimi dhe realizimi i 10 Parqeve në Komunën e Prizrenit	Kontratë	/	/	/	/	/	/	/
Rregullimi i oborrit te shkolles “LEF NOSI”	/	/	/	/	/	/	/	/

Masat e nivelit lokal për mbrojtjen e mjedisit

Masat	Masat konkrete	Statusi	Periudha e realizimit	Entiteti përgjegjës	Lokacioni	Fusha tematike	Plani/Vendimi
Masat për rregullimin e pellgjeve lumore në zonat urbane	Mirëmbajtja e shtratit të Lumbardhit	/	Vjetore	Komuna e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	Ujë	Plani vjetor
Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve	/	E planifikuar	/	Komuna e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	Ajër	Plani Vjetor nga MBPZHR
Masat për mbrojtjen e vlerave të natyrës që shpall Komuna	/	/	/	/	/	/	/
Masat emergjente për të normalizuar gjendjen e cilësisë së ajrit	/	/	/	/	/	/	/
Masa të tjera për mbrojtjen e mjedisit;	Furnizimi me pajisje për matjen e elementeve të ndryshme Aparati matës i zhurmës - kalibrues i zërit Aparatet për matjen e radioaktivitetit Aparate për ndotjen e ujit Aparati për matjen e cilësisë së ajrit	E planifikuar për vitin 2021	/	Komuna e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	/	/

4. Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Komuna e Prizreni ka raportuar se inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit dhe hartimi i raporteve përkatëse realizohet, por nuk janë ofruar hollësi të mëtutjeshme respektivisht raporte të tilla.

Përsëri edhe këtë vit gjendja e deponive të mbeturinave sipas zyrtarëve nuk monitorohet në tërësi, por vetëm pjesërisht, ndërkohë që nuk janë zhvilluar vlerësime të ndikimit të deponive ekzistuese të mbeturinave në mjedis.

Sa i përket monitorimit të gjendjes së zonave të mbrojtura Drejtoria e Inspektoratit ka raportuar se monitorimi i zonës së mbrojtur "Prevalla" realizohet sipas planeve të kësaj drejtorie, duke mos ndarë të dhëna të tjera mbi këtë raport dhe duke theksuar se hapësirat tjera të mbrojtura janë kompetencë e MMPHI-së. Ndërsa për monitorimin e gjendjes së pyjeve së bashku me gjendjen shëndetësore të tyre nga Drejtoria e Bujqësisë është thënë se ka monitorim 24 orësh nga Autoriteti Pyjor Komunal në Prizren.

Sa i përket çrregullimeve mjedisore, përgjegjësia i është adresuar Drejtorisë së Inspektorateve, është raportuar se ka raste të ndryshme të identifikimit të çrregullimeve mjedisore të cilat janë adresuar tek organet kompetente komunale dhe MMPHI. Kjo drejtori po ashtu ka raportuar se gjatë vitit 2022 ka pasur vetëm një inspektor mjedisor dhe se janë adresuar 4 gjoba mandatore për ndotje të mjedisit dhe 9 aktvendime të adresuara në gjykatën themelore. Ndërsa më tutje kanë theksuar se kanë evidentuar edhe raste të tejkalimit të splotimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara, për raste të tilla së bashku me inspektorët e KPMM-së, MMPHI-së dhe organet policore kanë kryer inspektime dhe kanë konfiskuar makineri punuese në terren si dhe janë dhënë ndëshkime të bazuara në ligjet në fuqi.

Autoriteti Pyjor Komunal, përmes Komisionit të përbashkët me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, ka bërë regjistrimin e pyjeve, sipas UA-05/2010, dhe ka konstatuar se nuk ka shkelje në menaxhimin e burimeve drusore dhe jo drusore.

Po ashtu Drejtoria e Bujqësisë ka raportuar se Komuna e Prizrenit ka themeluar vendgjuetitë për të cilat ka hasur vështirësi pas mbylljes së procedurave të tenderimit pasiçë ka pasur ankesa nga disa shoqata dhe se kjo si procedurë për momentin është në gjykatë.

Raportet mjedisore në nivelin lokal

LLOJI I RAPORTIT	EMRI I DOKUMENTIT	STATUSI	KOHA E HARTIMIT	PERIUDHA E RAPORTIMIT	KOMENTE
Raporti zbatimit të Planit të Veprimit në Mjedis	Raporte mujore	E zhvilluar dhe përditësohet në mënyrë sistematike	2022	Janar 2022	
Raporti i zbatimit të Programeve Mjedisore	Plani vjetor	E zhvilluar dhe përditësohet në mënyrë sistematike	/	Në fund të çdo viti	
Raporti i zbatimit të Planit të Menaxhimit të Mbeturinave	Plani vjetor	E zhvilluar dhe përditësohet në mënyrë sistematike	/	Në fund të çdo viti	
Raporti i zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal	DUPH	/	/	/	/
Raporti i zbatimit të Hartës Zonale të Komunës	DUPH	/	/	/	/
Raporte të zbatimit të Programit për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave	Drejtoria e Emergjences	/	/	/	

5. Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Prizrenit edhe në vitin 2022 nuk ka pasur sistem të monitorimit të cilësisë ajrit, përpos stacionit fiks të IHMK-së. Zyrtarët komunalë kanë bërë të ditur se sapo ka përfunduar procesin për furnizim me mjete matëse të ndryshme. Sipas tyre, furnizimi është realizuar për matësin e zhurmës, aparatet për matjen e radioaktivitetit, aparatet për matjen e ndotjes së ujit, si dhe aparatet për matjen e cilësisë së ajrit. SMMM ka pohuar se do të funksionalizohen 7 stacione (sensorë) për matjen e cilësisë së ajrit, 2 në zonën urbane (në objektet e shkollave “Motrat Qiriazit” dhe “Remzi Ademaj”) dhe 5 tjera në fshatrat Reçan, Lutogllavë, Piranë, Gjonaj dhe Zhur (Vlashnje).

Komuna e Prizrenit nuk ka sistem të monitorimit të dheut, e as sistem të monitorimit të cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ndërsa parashikimi dhe paralajmërimi i hershëm i vërshimeve dhe thatësirave, sipas zyrtarëve komunalë bëhet nga niveli qendror respektivisht AME, por është theksuar se kjo drejtori gjatë viti 2023 do të formojë Planin e Veprimit të Rrezikut në Komunën e Prizrenit ku do të identifikohen edhe zonat e thata.

Administrata lokale nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore. Sipas zyrtarëve komunalë, DSHP-ja nuk ka kapacitete të nevojshme teknike e as njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore, pasi që në SMMM siç është cekur më lartë janë të angazhuar vetëm 5 punonjës.

SMMM mirëmban sistemin e të dhënave sa i përket sasisë së mbeturinave komunale.

6. Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Prizrenit bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore e kanë vlerësuar si të pamjaftueshëm. Ngjashëm është vlerësuar edhe bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror sa i përket hartimit të strategjive mjedisore.

Sipas tyre niveli i bashkëpunimit me organizatat joqeveritare sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme është në nivel të kënaqshëm, ku përfshihen aktivitete të ndryshme për promovimin e mbrojtjes së mjedisit, si dhe subvencionimi i tyre (30,000 €) për realizimin e programeve të tyre për çështjet mjedisore. Njëherësh është theksuar se hartimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, është zhvilluar përmes konsultimit publik, dhe pjesëmarrjes së OJQ-ve dhe shoqatave tjera, ku janë marrë propozimet dhe janë përfshirë në draft Rregullore.

7. Licencimi dhe lejet mjedisore

Raportimi i Komunës mbi numrin e licencave dhe lejeve mjedisore aktive, nuk është i plotë ngase është ofruar vetëm lista e lejeve mjedisore të lëshuar nga DSHP-ja për vitin 2022, teksa sa i përketë licencave Drejtoria e Bujqësisë ka raportuar se nuk kanë lëshuar asnjë licencë për prerjen e drunjëve në pyjet publike por vetëm 15 leje janë lëshuar për prerjen e drunjve në pyje private. Ndërsa sa i përketë llojeve tjera të licencave si organ kompetentë sipas tyre është Agjencia e Pyjeve të Kosovës.

Pra sipas të dhënave të paraqitura nga Komuna në vitin 2022 janë lëshuar gjithsejtë 84 leje mjedisore. Sa i përket lejeve ujore nuk janë ofruar të dhëna nga SMMM.

Nr.	Nr. Identifikues	Emri - Subjekti	Adresa e investitorit	Lokacioni i projektit	Tarifa komunale
1	05-352-160672	Binak Çoçaj	Ferizaj	Landovice-Pz	1,240.00
2	05-352-184895	Zhuri Shpk	Pz	Zhur	300.00
3	05-352-187224	Sopaj shpk	Pz	Pz	6,506.54
4	05-352-187386	Ali Krasniqi	Pz	Pz	3,867.19
5	05-352-192882	Naser Gashi	Pz	Dushanove-Pz	241.00
6	05-352-193205	Rexhep Gashi	Pz	Pz	50.00
7	05-352-196287	Enver Hoti	Pz	Pz	501.96
8	05-352-7339	Fatmir Kamberaj	Pz	Pz	885.61
9	05-352-9314	Jakup Berisha	Suhareke	Pz	4,500.00
10	05-352-12164	Lumni Hameli	Mazrek-Pz	Pz	243.00
11	05-352-18650	Swiss Creative Group	Pz	Pz	3,640.00
12	05-352-27873	Rexhep Ndrecaj	Pz	Dushanove-Pz	340.24
13	05-352-28125	Shpetim Makshana	Drenoc-Rahov	Dushanove-Pz	440.00
14	05-352-35088	FE-PLAST shpk	Pz	Lubizhde-Pz	394.00
15	05-352-36370	Ramadan P.-Bashkimi	Prishtine	Pz	Anular
16	05-352-36159	Besim Mustafa,T.Guzhda	Pz	Pz	3,500.00
17	05-352-39824	Reshit,Muhamet-Ma-pr	Pz	Pz	4,020.00
18	05-352-41086	Kabashi Holding shpk	Pz	Pz	MMPH
19	05-352-43183	FAT Group shpk	Pz	Pz	4,300.13
20	05-352-49361	ABI SHPK	Pz	Pz	24,300.13
21	05-352-48479	Adilje Alija-rest.BOTA	Pz	Pz	//////
22	05-352-51838	Arsim Kryeziu	Pz	Pz	440.06

23	05-352-56630	Feriz Mustafa	Pz	Pz	200.00
24	05-352-57731	Skender Ukaj	Korishe-Pz	Pz	1,041.00
25	05-352-63133	Lulzim Elezkurtaj	Zhur	Zhur-Pz	///////
26	05-352-64026	Albin Kabashi	Pz	Lubizhde-Pz	561.87
27	05-352-69492	Lumturi Hoti	Pz	Pz	1,405.79
28	05-352-74844	Armend Spahiu	Pz	Dushanove-Pz	////////
29	05-352-78590	Rient shpk	Pz	Pz	672.00
30	05-352-79228	P.I.Holandez shpk	Pz	Petrove-Pz	1,306.88
31	05-352-79235	P.I.Holandez shpk	Pz	Petrove-Pz	338.02
32	05-352-80011	Shaqir- Besim Rrahmanaj	Pz	Dushanove-Pz	2.200.00
33	05-352-80769	Taip Rrustemi,LM	Pz	Lubizhde-Pz	15,186.28
34	05-352-84141	Shukri Struzha,Sh.Mazreku	Pz	Pz	1,183.38
35	05-352-88209	Rient shpk	Pz	Pz	545.60
36	05-352-92693	Ismet Rakaj	Pz	Pz	3,360.00
37	05-352-87243	Ramadan P.-Bashkimi	Pz	Pz	8,401.00
38	05-352-94916	SWIS BAU spk	Pz	Pz	3,410.73
39	05-352-98519	Sadik T-Daj Rrah	Pz	Pz	850.00
40	05-352-101125	Zehadin Berisha	Pz	Pz	49.00
41	05-352-104114	Skender dhe Besart Shengyl	Pz	Pz	1,609.95
42	05-352-104372	Immoland SHPK	Pz	Pz	11,571.00
43	05-352-106655	ABI SHPK	Pz	Pz	6,500.00
44	05-352-111242	SWIS BAU spk	Pz	Pz	Anular
45	05-352-112573	Driton Xharra	Pz	Pz	12,001.56
46	05-352-113138	Idriz Temaj B.I.	Pz	Dushanove-Pz	50.00
47	05-352-114404	Feriz Mustafa	Pz	Lubizhde-Pz	300.27
48	05-352-114368	3N costruction	Pz	Pz	1,232.03
49	05-352-113631	Arijon invest-NSHT'Astra	Pz	Pz	6,461.83
50	05-352-115565	Ganimete B,Fati-Alu plast	Pz	Pz	1,871.79
51	05-352-119352	Istref,Safet dhe Sk.Bytyqi	Pz	Pz	4,903.03
52	05-352-119312	Visar fanaj - Qazim Morina	Pz	Pz	1,630.00
53	05-352-119457	Bujar Hoti -Rabi Aliismet	Pz	Pz	2,192.30

54	05-352-117705	Hezer,Elesa,Iljaz dhe Hamdi Shatri	Pz	Pz	2,900.44
55	05-352-121982	NTSH Rimed	Pz	Pz	
56	05-352-123485	Sinan , ismail Krasniqi-Nord	Pz	Pz	611.47
57	05-352-125863	Afit Limani	Plajane	Plajane	94.00
58	05-352-128449	B. Rexhepaj dhe Geoterm	Pz	Pz	
59	05-352-129802	REGB shpk	Pz	Pz	4,600.00
60	05-352-132525	Sejran Krasniqi	Pz	Pz	827.75
61	05-352-133493	Rrahim Bytyqi-CIMA con.	Fushe Kosove	Lubizhde-Pz	8,036.28
62	05-352-138645	Miranda Shala	Pz	Korishe-Pz	370.00
63	05-352-138343	Tyran,Nadire- Toni Residenc	Pz	Pz	4,600.00
64	05-352-140682	NPN"Drenari"shpk	Prishtine	Pz	
65	05-352-144744	Casa itallia shpk	Pz	Lubizhde-Pz	1,100.00
66	05-352-150787	IMN Tulltorja	Landovice-Pz	Landovice-Pz	1,895.26
67	05-352-152158	Edin,Varis Gashi	Pz	Pz	1,694.00
68	05-352-152907	Gjykata Th-Pz	Pz	Pz	
69	05-352-153996	Lazime Ademai-02	Pz	Pz	580.00
70	05-352-157416	Sopaj shpk	Pz	Pz	
71	05-352-157630	Selajdin Fanaj B.l.	Pz	Pz	2,266.06
72	05-352-157739	Driton Gavazaj	Pz	Dushanove-Pz	
73	05-352-157756	Sefe Fetoshi	Pz	Lubizhde-Pz	400.10
74	05-352-158901	Edilgranit shpk	Pz	Dushanove-Pz	
75	05-352-159632	Liburnia Impex	Pz	Pz	720.00
76	05-352-160294	Besim Morina	Pz	Dushanove-Pz	
77	05-352-162232	Lulzim Paqarizi-Hidroregjioni	Pz	Pz	
78	05-352-162936	Moni Bau	Pz	Lubizhde-Pz	4,866.01
79	05-352-163244	Smaj Temaj-Kawa home	Prishtine	Lubizhde-Pz	2,155.95
80	05-352-166404	IMN Tulltorja	Landovice-Pz	Landovice-Pz	Anular
81	05-352-167512	NEWCO ELAN Shpk	Pz	Pz	14,000.00
82	05-352-169967	Tasim Taç	Mamushe		
83	05-352-170405	Besnik,Lulzim Gashi	Pz	Lubizhde-Pz	
84	05-352-170337	Erdal Ukallo	Pz	Jabllanice-Pz	

Përfundime

Gjetjet e këtij raporti janë validuar nga zyrtarët përkatës komunalë, duke pohuar se ato pasqyrojnë gjendjen reale në sektorin e mjedisit, bashkë me mundësitë për të ngritur dhe përmirësuar çështjet mjedisore në këtë komunë. Burimet njerëzore dhe financiare sipas tyre nuk janë të nivelit të mjaftueshëm, gjë që mbase reflektohet edhe në gjendjen aktuale mjedisore.

Bazuar në monitorimin e vitit 2022, konkluzionet nuk kanë ndonjë ndryshim të theksuar me ato të vitit 2021:

Komuna e Prizrenit ka krijuar organ përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit, por kapacitetet njerëzore brenda këtij organi janë të pamjaftueshme si në aspektin kuantitativ ashtu edhe në atë profesional, ndërkohë që nuk ka pasur as aktivitete për fuqizimin e tyre në raport me kornizën aktuale ligjore dhe në periudhën raportuese nuk është organizuar asnjë trajnim rreth çështjeve mjedisore për stafin e SMMM.

Njohuritë e stafit komunal rreth kornizës mjedisore nuk janë të nivelit më të lartë, derisa përcaktimi i sfidave me të cilat ata ballafaqohen si rrjedhojë e mangësive ligjore në fushën e mjedisit ka qenë i pamundur për shkak të mos listimit të tyre nga punonjësit e SMMM.

Shkalla e hartimit dhe zbatimit të politikave lokale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor mbetet problematike, për faktin se nuk ka organizim të mirëfilltë në këtë aspekt; përkatësisht, rrjedha aktuale e hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit aktualisht e bën të vështirë matjen e efikasitetit të këtyre veprimeve në përmirësimin e gjendjes mjedisore.

Niveli i inspektimit si dhe hartimi i raporteve përkatëse lidhur me zbatimin e kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit dhe të zbatimit të strategjive mjedisore mbetet i paqartë për shkak të mos shpalosjes së të dhënave të plota në këtë drejtim, derisa është pranuar se në tregues të caktuar nuk ka monitorim.

SMMM në Komunën e Prizrenit ende nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore, për shkak të mungesës së resurseve teknike dhe njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Bashkëpunimi ndërinstytucional në hartimin e politikave publike vlerësohet të jetë i pamjaftueshëm. Praktika e DSHP-së për takime me aktivistët e shoqërisë civile, me qëllim të shqyrtimit të mundësive për një bashkëpunim më efektiv në mes të Komunës dhe OJQ-ve që veprojnë në fushën e mjedisit është ndërprerë pas vetëm disa takimesh. Kësisoj bashkëpunimi me shoqërinë civile në hartimin e politikave lokale mbetet i pamjaftueshëm, ashtu sikurse edhe pjesëmarrja e publikut në hartimin strategjive lokale. Ndërsa sipas të dhënave të paraqitura nga Komuna në vitin 2022 janë lëshuar gjithsejtë 84 leje mjedisore. Sa i përket lejeve ujore nuk janë ofruar të dhëna nga SMMM teksa kemi edhe 15 licenca të lëshuara për prerjen e drunjve në pyje private.

Rekomandime

- Të shqyrtohen mundësitë për shtimin e punonjësve profesionistë në SMMM;
- Të organizohen trajnime për punonjësit e SMMM rreth kornizës ligjore dhe rreth çështjeve mjedisore;
- Të përmirësohet dhe dinamizohet hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit;
- Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor të përditësohen, bashkë me fuqizimin e raportimit të zbatimit të tyre;
- Të rriten kapacitetet si dhe të shtohet mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor;
- Të fillojë sa më shpejtë procesi i krijimit, grumbullimit, menaxhimit të të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave mjedisore;
- Të avancohet bashkëpunimi nivel qendror - lokal në hartimin e akteve ligjore dhe strategjive mjedisore; dhe
- Të kultivohet bashkëpunimi më i afërt me OJQ-të për të nxitur rritjen e pjesëmarrjes së publikut në çështjet mjedisore;

Për EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të këtyre programeve: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse, Zhvillim i Qëndrueshëm dhe Mjedis e Ndryshime Klimatike.

Ndërsa programi tjetër është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

- 1.Vëllimin e pamjaftueshëm të dijës empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
- 2.Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
- 3.Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020-2024) ka këto elemente:

- 1.Gjithëpërfshirjen, 2.Qëndrueshmërinë, dhe 3.Dijen.

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijës së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.

www.ecmandryshe.org